URDHËR
Nr. 355, datë 18.12.2012

PËR KRITERET E MIRATIMIT TË LABORATORIT TË REFERENCËS

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 17 pika 4 të ligjit nr. 10 390 datë 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë",

URDHËROJ:

1. Kriteret që duhet të plotësojë laboratori me qëllim miratimin si laborator i referencës, janë si më poshtë:

a) analiza e mostrave të plehut për efekt të verifikimit të treguesve të deklaruar, të kryhet në përputhje me të gjitha kriteret për procedurat laboratorike dhe zbatimin e metodave;

b) të ketë kryer akreditimin bazuar në standardin "Standarde shqiptare: SSH EN ISO/IEC 17025:2006";

c) të hartojë rregulloren për funksionimin e laboratorit;

d) të mbajë regjistrat laboratorikë të regjistrimit të mostrave dhe të kryerjes së analizave bazuar në rregulloren e laboratorit;

e) të zbatojë metodikat e kryerjes së analizave të plehut bazuar në standardet shqiptare SSH të adoptuara dhe të miratuara në kodin 65080 për plehrat;

f) plotësimi i fletanalizës me rezultatet përfundimtare të bëhet në mënyrë elektronike në tri kopje, ku secila kopje të firmoset nga analizuesi, përgjegjësi i laboratorit, si dhe titullari i institucionit, dhe të vulosen dhe të protokollohen;

g) përbërja e stafit kimist dhe laborant, të jetë me eksperiencë dhe me kualifikim të nevojshëm në fushën e zbatimit të procedurave dhe të metodave të analizave laboratorike, dhe kjo eksperiencë të evidentohet me dokumentacionin përkatës;

h) zbatimi i kritereve të mësipërme do të verifikohet nga një grup pune i ngritur posaçërisht për këtë qëllim nga Ministri.

2. Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli